

STATUT
I
SHOQERISE " BIBLEKAJ " Sh.p.k

Lezhë, më 01.08.2023

KREU I

KRIJIMI, FORMA, EMERTIMI, OBJEKTI, SELIA, DHE KOHEZGJATJA E SHOQERISE.

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar "**BIBLEKAJ**" Sh.p.k me seli në *Lezhe, Shenkoll, Tale, Gryke lumi, zona kadastrale 1879, pasurine nr. 11/178*, është krijuar sot me date 01.08.2023 sipas aktit të themelimit dhe ketij statuti i përpiluar dhe nënshkruar nga :

1. **Z. Ardijan Biblekaj** me atesi Zef i datelindjes 28.06.1984, lindur Ebikon, Luzen, Zvicer dhe banues ne Hausmatterstr 29, 5735 Pffeffikon, Luzern, Zvicer, shtetas zviceran, madhor dhe me zotesi të plote juridike dhe për të vepruar, identifikuar nepermjet pasaportes nr. X7289897 dhe me nr. Personal X7289897.

E hartojmë këtë Statut të Shoqërisë "**BIBLEKAJ**" Sh.p.k, mbështetur ne ligjin 9901 date 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", ligjin 9723 date 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit", Kodin Doganor, Fiskal e Tatimor, si me poshtë:

Neni 1

Krijimi

Shoqëria e fiton personalitetin juridik nga dita e regjistrimit të saj.

Emërtimi i shoqërisë është "**BIBLEKAJ**" Sh.p.k

Kjo shoqëri është person juridik i të drejtës shqiptare, Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (me poshtë e quajtur "Shoqëria").

Neni 2

Personaliteti juridik

Shoqëria "**BIBLEKAJ**" Sh.p.k, është një shoqëri tregtare, e themeluar nga "ortaku i vetem i shoqërisë", i cili përgjigjet për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulon personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara. Kontributet e ortakut përbëjnë kapitalin e regjistruar të shoqërisë.

Neni 3

Selia

Shoqëria e ka selinë në Lezhe, Shenkoll, Tale, Gryke lumi, zona kadastrale 1879, pasurine nr. 11/178. Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, të hapë zyra përfaqësie, dege, të krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendim të asamblesë së ortakeve.

Neni 4

Objekti i veprimtarisë

Shoqëria do të ketë për objekt të veprimtarisë të saj ushtrimin e aktivitetit në fushën e : *Agjensi ndermjetesimi për shit-blerje pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme. Tregetim të materiale të ndryshme ndertimi, makineri të ndryshme, tregetim të automjeteve dhe shitje dhe blerje të tyre etj.*

Neni 5
Kohëzgjatja

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore të pacaktuar.

KREU II
KAPITALI

Neni 6
Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë është **100.000 (njqindmije) leke** i përbërë nga 1 kuote dhe zotërohet nga ortaku i vetem i shoqërisë përkatësisht:

1. ARDIJAN BIBLEKAJ me 100 % te kapitalit = 1 kuote

Te gjitha pjesët e kapitalit themeltar janë nënshkruar e shlyer krejtësisht.

Kapitali themeltar është i përbërë nga një kuotë me vlerë **100.000 leke**.

Kjo kuotë i përket ortakut të vetem Ardijan Biblekaj

Çdo kuote i takon e drejta e një vote.

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme. Kontributi i ortakeve mund të jete në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme / të paluajtshme apo të drejta).

Ortaku, që pengohet të ushtroje të drejtat që i rrjedhin nga zotërimi i kuotës së shoqërisë, ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës të urdhërojë ndalimin e cenimit apo shpërblimin e demit të shkaktuar, si pasojë e cenimit të këtyre të drejtave. Kjo e drejtë parashkruhet brenda 3 vjetëve nga çasti i cenimit.

Neni 7
Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emërimit nga gjykata kompetente e një eksperti të autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

Në asnjë rast shumica nuk mund të detyroje një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakeve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvogëlimi prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

Vendimi për ndryshimin e kapitalit i njoftohet Qendrës Kombëtare të Biznesit për regjistrim nga administratori, në përputhje me nenin 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit".

Neni 8
Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;

- b) Shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- d) dhurimit;
- e) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Ne rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të behet me shkrim.

Ky statut kushtëzon kalimin e kuotave të tretëve jashtë shoqërisë, me miratimin e shoqërisë dhe të drejtën e parablerjes në favor të shoqërisë apo të ortakëve të tjerë, sipas modaliteteve dhe shumicës së cilësuar që kërkon ndryshimi i statutit.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit të saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit". Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU III ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 9

Organi Vendimmarrës

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të eksperteve kontabël të autorizuar;
- d) Përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "d" të kësaj pike;
- dh) Mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.
- j) Te gjithë veprimet që kanë të bëjnë me shitjet - blerjet, lidhjet e kontratave me të tretet

te çdo lloji, me organet qendrore etj do te kryhen vetëm nga personi apo personat e autorizuar me vendim te asamblesë se ortakeve .

k) Kontratat e punës se punonjësve, paga e shpërblimi i tyre do te bëhen nga personi apo persona te autorizuar me vendim te asamblesë se ortakeve.

l) Ndarja e fitimit dhe shpërblimi midis ortakeve do te behet me vendim te asamblesë se ortakeve.

m) Me vendim te asamblesë se ortakeve caktohen personi apo personat qe do te përfaqësojnë shoqërinë përpara bankave të çdo niveli qe operojnë ne Republikën e Shqipërisë, ne këtë vendim do te përcaktohet ne mënyrë te detajuar kompetencat e personit apo personave qe do te veprojnë ne emër te shoqërisë me bankat. Edhe administratori i shoqërisëdo te hape l llogari apo kryeje veprime me bankat vetëm me autorizim te asamblesë se ortakeve te shoqërisë

Ortaku mund te përfaqësohet ne asamblene e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i trete.

Administratori i shoqërisë nuk mund te veproje si përfaqësues i ortakeve ne asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund te jepet vetëm për një mbledhje te asamblesë se përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me te njëjtin rend dite.

Neni 10

Mënyra e thirrjes se mbledhjes se Asamblesë se Përgjithshme

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkrese ose me njoftim nëpërmjet postes elektronike. Njoftimi me shkrese apo me mesazh elektronik duhet te përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet te gjithë ortakeve, jo me vone se 7 dite përparadatës se parashikuar përmbledhjen e asamblese. Kur"asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 te këtij neni, ajo mund te marre vendime te vlefshme vetëm nëse te gjithë ortaket janë dakord, për te marre vendime, pavarësisht parregullsisë.

Neni 11

Kuorumi

a) Ne rastin e marrjes se vendimeve, qe kërkojnë një shumice te zakonshme, asambleja e përgjithshme mund to marre vendime te vlefshme vetëmnëse marrin pjese ortaket me te drejte vote, qezotërojnë me shume se 30 për qind te kuotave.

b) Ne rastin kur asambleja e përgjithshme duhet te vendose përçështje, te cilat kërkojnë shumicë te kualifikuar sipas nenit 87 te ligjit " Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare ", ajo mund te marre vendime te vlefshme vetëm, nëse ortaket që zotërojnë me shume se gjysmën e numrit total te votave, janë te pranishëm personalisht, votojnë me shkrese, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve te pikës 3 te nenit 88 te këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund te mblidhet për shkak te mungesës se kuorumit te përmendur me lart, asambleja mblidhet përsëri jo me vone se 30 dite, me te njëjtin rend dite.

Neni 12

Marrja e vendimeve

Asambleja e përgjithshme për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit te regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, miratimin e bilancit, kontrollin e llogarive, miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblesë, riorganizimin, bashkimin ose ndarjen e shoqërisë, shndërrimin ne një forme tjetër, transferimin e kuotave, emërimin e eksperteve dhe

likuidatorëve dhe prishjen e shoqërisë, zhvillon mbledhje te jashtëzakonshme, te cilat janë te vlefshme, kur ne te janë te pranishëm ortaket me te drejte vote qe zotërojnë me shume se gjysmën e numrit total te kuotave te kapitalit te shoqërisë te cilët votojnë me shkrese, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve te pikës 3 te nenit 88 te këtij ligjit 9901 date 14.04.2008 dhe merren vendime te vlefshme me votimin pro te 3/4 te ortakeve pjesëmarrës. Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave te ortakeve pjesëmarrës, kur ne te marrin pjese ortaket me te drejte vote te cilët zotërojnë me shume se 30 për qind te kuotave përçështje te tjera si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare te shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratoreve; e
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe te eksperteve kontabël te autorizuar;
- c) përcaktimin e shpërblimeve,
- d) mbikëqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurisë se veprimtarisë;
- d) përfaqësimin e shoqërisë ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve; Çdo ndryshim statuti duhet te depozitohet pranë QKB për te pasqyruar ndryshimet ne skedën e shoqërisë.

Neni 13 *Administrimi*

Shoqëria do te administrohet nga një Administrator.

Administrator i shoqërisë emerohet **Z. Ardijan Biblekaj** me atesi Zef i datelindjes 28.06.1984, lindur ne Ebikon, Luzen, Zvicer dhe banues ne Hausmatterstr 29, 5735 Pfeffikon, Luzern, Zvicer, shtetas zviceran, madhor dhe me zotesi te plate juridike dhe per te vepruar, identifikuar nepermjet pasaportes nr. X7289897 dhe me nr. Personal X7289897, i cili do te ushtroje detyrat e administrimit sipas statutit dhe ligjit për një periudhe 5 vjeçare me te drejte ripërtëritje.

Neni 14 *Kompetencat*

Administratori ka te drejte e detyrohet te:

- a) kryeje të gjitha veprimet e administrimit te veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, te vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësoje shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e sakte e të rregullt të dokumenteve dhe te librave kontabël te shoqërisë;
- c) Te nënshkruaje bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë se veprimtarisë dhe, se bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë se përgjithshme për miratim;
- d) krijoje një sistem paralajmërimi ne kohen e duhur për rrethanat, qe kercenojne mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryeje regjistrimet dhe dërgojnë te dhënat e detyrueshme te shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare te Biznesit.
- e) raportoje përpara asamblesë se përgjithshme ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posaçme me rëndësi te veçante për veprimtarinë e shoqërisë

tregtare;

- f) Administratori ka të drejte të përfaqësoje shoqërinë përpara organeve të drejtësisë, gjykatës e prokurorisë, organeve të administratës shtetërore qendrore apo lokale, zyrës së tatimeve
-Administratori ka të drejte të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm të shoqërisë.

Neni 15

Përgjegjësitë

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë. Pasojat e marrëveshjeve të pa miratuara nga asambleja që i sjellin dem shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", administratori detyrohet:

1. a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçante ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;

b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;

c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;

g) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personale me ata të shoqërisë;

d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me to kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara.

4. Në mënyrë të veçante, po pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit „Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare kryen veprimet e mëposhtme:

a) u kthen ortakevekontributet;

b) u paguan ortakeve interesa apo dividendë;

c) u shpërndan aktivet shoqërisë;

c) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi pagueuese për të shlyer detyrimet;

d) jep kredi.

Përveç padisë për shlyerjen e demit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose së bashku, kanë të drejte të ngrenë padi penale kundër administratorit Paditësit kanë të drejte të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plote të demit që i është shkaktuar

shoqërisë, përfshire edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme.

Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

Neni 16 Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përgjatë vitit, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 17 Bilanci i shoqërisë dhe dividendet

Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit financiar, Mbledhja e Ortakeve, miraton bilancin e paraqitur nga Administratori.

Mbledhja e Ortakeve vendos rreth shpërndarjes së dividendit, pasi të jenë zbritur humbjet e vitit të mëparshëm financiar, siç edhe parashikohet nga ligji.

Neni 18 Ekspertet

Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë të ngarkuar nga ana e ortakeve.

Në përfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'ja paraqesë e dorëzojë në kohë ortakeve për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

Neni 19

Te ardhurat neto që mbeten pas veçimit të fondeve ligjore dhe të atyre për shlyerjen e çdo detyrimi fiskal apo likuidimit të pagesave ndaj të tretëve, i mbeten dhe i kalojnë në pronësi të ortakeve.

Neni 20

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të behet në çdo kohë :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të Asamblesë së Ortakeve;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;

c) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me piken 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit";

- d) me vendim të gjykatës;

Në këtë rast Ortaket marrin vendim me shkrim në të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatorë dhe shënuar në çdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtese " Shoqëri në likuidim e sipër ".

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasoje hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë

paguese, me përjashtim te rasteve kur është nisur një procedure falimentimi. Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emeruar nga Ortaket.

Nëse Ortaket nuk marrin një vendim përemërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykate, për te caktuar një likuidues.

Neni 21

Likuiduesi merr përsipër te drejtat dhe detyrimet e administratoreve nga data e emërimit te tij. Nëse shoqëria emëron me shume se një likuidues, pervecse kur akti i emërimit parashikon se ata veprojnë veçmas njeri-tjetrit, likuiduesit ushtrojnë bashkërisht te drejtat e detyrimet sipas këtij ligji. Likuiduesit mund te autorizojnënjërin prej tyre te kryeje veprime te një kategorie te posaçme. Kufizimet e tagrave te likuiduesve u kundrejtohen te tretëve, ne përputhje me përcaktimet e ligjit. Likuiduesi u nënshtrohet mbikëqyrjes se ortakut dhe administratorit.

Neni 22

Baza Ligjore

Shoqëria do te kete aktivitetin e tij ne përputhje te plote me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqipetar.

Për sa nuk parashikohet ne këtë statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtaret dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik ne Republikën e Shqipërisë.

Neni 23

Mosmarrëveshjet

Për mosmarrëveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje qe mund te linde midis Shoqërisë dhe te tretëve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptare.

Neni 24

Dispozita përfundimtare

Ky statut u redaktua ne 4 ekzemplare me përmbajtje dhe vlera te njëjta juridike, ne gjuhen shqipe, u miratua, ne parim nen për nen nga Ortaket e shoqërisë tregtare "FLOGEN CONSTRUCTION" Sh.p.k, nënshkruhet ne te gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmën origjinale.

**ORTAKU I VETEM
ARDIJAN BIBLEKAJ**


